



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1777/2 prot.

Tiranë më 15. 8. 2024

UDHËZIM

Nr. 2011, datë 15. 8. 2024

PËR

**PROCEDURAT DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË USHTARËVE/DETARËVE
AKTIVË NË FORCAT E ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të germës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

1. Hyrje.

Forcat e Armatosura përfaqësojnë një element kyç të identitetit tonë kombëtar, po aq me rëndësi është edhe përfaqësimi i të gjithë vendit dhe shoqërisë në Forcat e Armatosura. Do të rishikohet dhe do të përmirësohet në vijimësi procesi dhe strategjia e rekrutimit, duke i çuar Forcat e Armatosura te publiku. Synimi ynë do të jetë rekrutimi në raporte të drejta përfaqësimi gjinor dhe rritja e cilësisë në rekrutimin e kandidatëve që dëshirojnë të shërbejnë në radhët e FA-së.

Rekrutimi i ushtarëve/detarëve ka një ndikim të rëndësishëm mbi të ardhmen e Forcave të Armatosura. Për këtë arsye kërkohet që të rekrutohen shtetas me një profil cilësor, të aftë nga ana

fizike dhe shëndetësore dhe me një nivel të lartë kulturor. Një gjë e tillë mund të arrihet nëpërmjet përsosjes së mëtejshme të sistemit të përzgjedhjes, lehtësimin e procedurave të aplikimit, testimeve të pranimit, ekzaminimeve shëndetësore dhe transparencës së procesit, me qëllim realizimin e kuotave të planifikuara për rekrutim për ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura.

2. Qëllimi.

Udhëzimi “Procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura” përcakton parimet, objektivat, kriteret, standardet, përgjegjësitë e strukturave, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të tyre gjatë gjithë ciklit të plotë të procesit të rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë.

3. Parimet.

Rekrutimi i ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura duhet të ofrojë shanse të barabarta të gjithë shtetasve shqiptarë, duke respektuar racën, etninë, ngjyrën, gjininë, përkatësinë fetare, vendbanimin etj. Procedurat e përzgjedhjes së ushtarëve/detarëve do të jenë transparente dhe të dokumentuara. Procedurat, kriteret, udhëzimet, rregulloret e testimeve dhe lista përfundimtare e rezultateve të testimit publikohen në faqen zyrtare të internetit të Forcave të Armatosura. Kryerja e testimeve të pranimit do të realizohet nëpërmjet testeve të përmirësuara, ndërsa vlerësimi i njohurive për nivelin intelektual do të realizohet nga sistemi i automatizuar.

4. Fusha e zbatimit.

Kërkesat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e politikës dhe procedurave të rekrutimit janë: Drejtoria e Personelit (J-1), Drejtoria e Logjistikës (J-4) dhe Inspektorati Shëndetësor Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR), Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DMBNJSH), Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së (QKMBM&M), Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), komandat e forcave kryesore dhe atyre mbështetëse, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura (PUFA), Njësia Mjekësore Ushtarake (NJMU), Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së (BMSHPFA), Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI).

5. Objektivat.

- a) rritja e standardeve të rekrutimit, përsosja e sistemit të përzgjedhjes, përmirësimi i instrumenteve të testimit dhe vlerësimit, trajnimi sipas specialiteteve dhe krijimi i mundësive për karrierë do të bëjnë të mundur rekrutimin e shtetasve me një profil cilësor, fizik dhe intelektual;
- b) rekrutimi i ushtarëve/detarëve aktivë për misionet dhe sfidat e reja që do të përballojnë Forcat tona të Armatosura, do të bëhet duke ruajtur e duke zhvilluar balancat midis kërkesës për moshë mesatare sa më të re në FA dhe nevojës për të qëndruar më gjatë në shërbimin

ushtarak; raporte të arsyeshme midis forcave/trupave të luftimit; forcave/trupave të mbështetjes së luftimit; forcave/trupave të mbështetjes me shërbime të luftimit, midis strukturave të shtabeve me trupën, me qëllim përzgjedhjeje sa më efektive nga kontingjentet që aplikojnë për të shërbyer në Forcat e Armatosura;

- c) rekrutimi sipas nevojave dhe mbi bazën e specialiteteve të Forcave të Armatosura, do të jetë synimi kryesor i procedurave të rekrutimit. Për këtë arsye përparësi do t'i jepet rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë dhe me aftësi të mira për specialitete të veçanta;
- ç) do të inkurajohet rekrutimi i kandidatëve femra për përfshirjen e tyre në strukturat operacionale dhe njësitë e repartet e luftimit;
- d) do të nxitet interesi i shtetasve për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura, nëpërmjet zhvillimit të një marketingu sa më efektiv.

6. Strukturat, autoritetet dhe përgjegjësitë.

- a) Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DMBNJSH);
- b) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-1);
- c) Drejtoria e Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm (J-4);
- ç) Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR);
- d) Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së (QKMBM&M);
- dh) Komandat e forcave kryesore dhe atyre mbështetëse;
- e) Akademia e Forcave të Armatosura (AFA);
- ë) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura (PU);
- f) Njësia Mjekësore Ushtarake (NJMU);
- g) Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së (BSHP);
- h) Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI).

a) Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve përgjigjet për:

- a) hartimin dhe rishikimin e procedurave dhe kriterëve për rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë në FA;
- b) monitorimin e zbatimit të procedurës dhe kriterëve.

b) Drejtoria e Personelit në Shtabin Përgjithshëm të FA (J-1) përgjigjet për:

- a) zbatimin e procedurave dhe kriterëve të rekrutimit të ushtarëve në FA;
- b) planifikimin e nevojave të rekrutimit dhe dërgimin e planeve vjetore të rekrutimit komandave të interesuara dhe QPR-së;
- c) përgatitjen e urdhrat për rekrutimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë dhe zhvillimin e stërvitjes individuale bazë, të ndarë me struktura, specialitete dhe rajone rekrutimi;
- ç) ndarjen me specialitete të kandidatëve në përfundim të stërvitjes individuale bazë;
- d) përgatitjen e praktikës së titullimit, gradimit dhe shpërndarjes së tyre;

dh) përgatitjen e urdhrave për ndërprerjen e stërvitjes individuale bazë dhe të shërbimit aktiv.

c) Drejtoria e Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-4).

Në bashkëpunim me J-1 në SHP, QPR-në dhe AFA-në, përgjigjet hartimin e praktikave dhe ndjekjen e procedurave për kompletimin me veshmbathje, si dhe mbështetjen me transport për kandidatët për ushtar aktivë gjatë zhvillimit të kontrolleve mjekësore dhe testimeve që zhvillohen pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit (QPR), si dhe dërgimin e tyre në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarit (QAPU) dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura.

Përgatit urdhrin e SHSHPFA-së për vënie mjetesh në dispozicion të seksioneve të rekrutimit në qarqe, në varësi të QPR-së, sipas planit të hartuar nga J-1 e QPR-ja, të cilat duhet të saktësojnë numrin e kandidatëve, datën, vendin e grumbullimit për në rajonet e zhvillimit të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB).

ç) Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR) përgjigjet për:

- a) rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura, mbi bazën e planit vjetor të rekrutimit, të detajuar me specialitete dhe kuota numerike;
- b) bashkëpunon me QKMBM&M për publikimin në faqen e internetit të MM-së të procedurës, kritereve të rekrutimit, dokumentacionit dhe afatit të dorëzimit, testimet që do kryhen dhe mënyra e vlerësimit të tyre, kuotat sipas specialiteteve dhe rajoneve të rekrutimit etj.;
- c) administrimin e dokumenteve të kandidatëve/aplikantëve, si dhe hedhjen e të dhënave në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- ç) zhvillimin e testimit fizik, testimit psikologjik, testimit intelektual të përgjithshëm, testimit intelektual profesional, sipas specialiteteve dhe shpalljen e rezultateve të tyre;
- d) dërgimin në Drejtorinë e Personelit në SHP të "Raportit të rezultateve përfundimtare";
- dh) marketingun për rekrutimin e ushtarë/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura në bashkëpunim me J-1 dhe J-9 në SHP, Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeun e FA-së dhe komandat e forcave/reparteve ku bëhet rekrutimi;
- e) dërgimin rast pas rasti në AISM dhe PU të listës së kandidatëve aplikues, me të dhënat e sakta personale, për vendbanimin, arsimimin, sipas dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët;
- ë) dërgimin në Drejtorinë e Personelit në SHP, të listës përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas kuotave të planit të rekrutimit të miratuar, që do të ndjekin stërvitjen individuale bazë.
- f) përgatitjen e dosjeve individuale në dy kopje dhe shpërndarjen e tyre pas emërimit në detyrë.

d) Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA-së:

- a) bashkëpunon me QPR-në për promovimin e vlerave të FA-së;

- b) përgjigjet për publikimin në faqen e internetit të MM-së të procedurës, kritereve të rekrutimit, dokumentacionit dhe afatit të dorëzimit, testimet që do kryhen dhe mënyra e vlerësimit të tyre, kuotat sipas specialiteteve dhe rajoneve të rekrutimit etj.

dh) Komandat e forcave kryesore dhe mbështetëse:

- a) në bashkëpunim me QPR-në dhe J-9 në SHPFA përgjigjen për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe informuese për rekrutimin në FA;
- b) të mbështesë QPR me personel ushtarak dhe me mjete transporti gjatë zhvillimit të fushatave të rekrutimit, si dhe gjatë zhvillimit të procedurave të testimit.

e) Akademia e Forcave të Armatosura (AFA).

- a) në bashkëpunim me DMBNJSH, QPR-në dhe J-1, është përgjegjëse për hartimin dhe përditësimin e testeve intelektuale për pranimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë në FA;
- b) është përgjegjëse për pritjen e rekrutëve në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarit në (QAPU) Bunavi, kompletimin me uniformë, akomodimin e tyre, si dhe për zhvillimin e stërvitjes individuale bazë;
- c) me përfundimin e stërvitjes bazë, i propozon Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, titullim e rekrutëve “ushtar/detar” aktiv dhe dërgon dokumentacionin e përfundimit të kursit në QPR, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij.
- ç) pas titullimit “ushtar/detar” dhe dhënies së gradës “ushtar/detar I” ose “ushtar/detar II”, komandat bëjnë emërimin e ushtarëve dhe dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm në Qendrën e Personel-Rekrutimit (QPR).

ë) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura (PUFA).

Në bashkëpunim me struktura të tjera, të bëjë kontrollin e plotësimit të kushtit të sigurisë të rekrutëve. Kontrolli i verifikimit të kushtit të sigurisë të përfundojë brenda 30 ditëve nga dërgimi i listës nga Qendra e Personel-Rekrutimit. Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura, gjithashtu, përgjigjet edhe për mbajtjen e rregullit, disiplinës dhe sigurimin e procesit të testimit, sipas procedurave standarde. Lista e verifikimit të kontrollit të plotësimit të kushtit të sigurisë të kandidatëve të përzgjedhur për ushtarë/detarë nga AISM-ja dhe PU-ja, të dërgohen në J-1 dhe QPR, ku të theksohet “plotëson kushtin e sigurisë” dhe “nuk e plotëson kushtin e sigurisë”.

- f) **Njësia Mjekësore Ushtarake e FA-së (NJMU)**, pranë Spitalit Universitar të Traumës, përgjigjet për kryerjen e kontrollit dhe përcaktimin e aftësisë/paafësisë fiziko-shëndetësore të shtetasve kandidatë për ushtarë/detarë aktivë.
- g) **Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së** të mbështesë Qendrën e Personel-Rekrutimit gjatë procesit të rekrutimit të kandidatëve për në FA, me orkestrën

frymore, me anë të Këshillit Artistik, transportin për personelin gjatë fushatës së marketingut, gjatë ditëve të zhvillimit të procesit të testimit, sipas kërkesave të QPR-së.

- h) Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI)** mbështet dhe përgjigjet për funksionimin e sistemit të rt.aaf.mil.al (Testimit intelektual, ndërfaqe e sistemit të automatizimit në rrjetin e klasifikuar), si dhe mbështetjen në rast të mosfunksionimit të linjës në rrjet.

KREU II

PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË USHTARËVE/DETARËVE

1. Procedurat e planifikimit për ushtarë/detarë aktivë.

- a) Në periudhën **prill-maj** të çdo viti, komandat e forcave, Komanda Mbështetëse, Akademia e Forcave të Armatosura, komandat e reparteve dhe strukturave të tjera, paraqesin pranë Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-I), nevojat dhe kërkesat për kompletimin e Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve me ushtarë/detarë aktivë për vitin pasardhës, sipas prioriteteve, specialiteteve dhe kërkesave për përmbushjen e nevojave;
- b) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, mbi bazën e nevojave dhe kërkesave, harton planin e rekrutimit, duke marrë në konsideratë prioritetet e përcaktuara, specialitetet, nevojat organike për çdo forcë, njësi e repart dhe numrin e personelit sipas gjinisë që duhet të rekrutohet. Planin e rekrutimit miratohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe ndahet me periudha;
- c) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, në muajin qershor, dërgon planin e rekrutimit në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe në Akademinë e Forcave të Armatosura për të planëzuar Stërvitjen Individuale Bazë dhe Stërvitjen Individuale të Avancuar në bazë të kapaciteteve stërvitore;
- ç) Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR), në zbatim të planit të rekrutimit, të miratuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, bën rekrutimin sipas rajoneve dhe specialiteteve, të kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë, për kompletimin e njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura;
- d) Qendra e Personel-Rekrutimit, Akademia e Forcave të Armatosura/Qendra e Arsimimit Profesional e Ushtarit (QAPU) dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, bashkërendojnë punën për fillimin e Stërvitjes Individuale Bazë (SIB) dhe më tej vijimin e Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA).

2. Kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë.

Për t'u rekrutuar në FA si ushtarë/detarë aktivë, shtetasit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjykimi;
- c) të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;

- c) të ketë figurë të pastër morale;
- d) të mos jetë i deportuar për kryerje të veprave penale;
- dh) të mos ketë probleme me drogën dhe alkoolin;
- e) shtetasit, në momentin e titullimit ushtarë/detarë nuk duhet të kenë mbushur moshën 30 vjeç, ndërsa për personelin mjekësor, si dhe personelin e Orkestrës frymore, Orkestrës Simfonike, shtetasit në momentin e titullimit ushtarë/detarë nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç;
- ë) të ketë kryer arsimin minimalisht 9-vjeçar, brenda ose jashtë vendit;
- f) të ketë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- g) të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;
- gj) të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse (ASIM, PUFA).

3. Procedurat e aplikimit për ushtarë/detarë aktivë.

- a) shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në FA si ushtarë/detarë aktivë, do të aplikojnë: online ose pranë seksioneve të rekrutimit në qarqe dhe në Qendrën e Personel-Rekrutimit;
- b) aplikantët/kandidatët plotësojnë formularët e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel-Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes etj.;
- c) procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të MM-së, me daljen e urdhrit të SHSHP të FA-së.

4. Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR.

4.1.Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) formularët e vetëdeklarimit;
- c) dy fotografi të përmasave 4x6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- c) dëftesën e shkollës 9-vjeçare, maturës shtetërore ose diplomën e institucionit të arsimit të lartë (IAL);
- d) fotokopjen e dëshmisë, certifikatës për aftësitë profesionale, gjuhësore etj.(nëse ka);
- e) dokumentin e qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes (raporti mjekësor për sëmundje infektive/kronike, ndërhyrje kirurgjikale/ortopedike që ka kryer individit gjatë jetës së tij);
- f) vërtetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti.

4.2. Qendra e Personel-Rekrutimit, pas marrjes së aksesit në portalin “e-Albania”, të sigurojë dokumentacionin (vërtetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti), sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.3.Qendra e Personel-Rekrutimit vijon procedurat e testimit dhe përzgjedhjes vetëm me kandidatët të cilët kanë paraqitur dokumentacionin sipas pikës 4.1, Kreu II.

5. Fazat dhe procedurat e konkurrimit.

Për t'u rekrutuar në FA, të gjithë aplikantët duhet të plotësojnë disa standarde për gjendjen shëndetësore, gjendjen fizike dhe edukim. Zhvillimi i konkurrimit përfshin:

- a) ekzaminimin shëndetësor;
- b) testimin fizik;
- c) testimin intelektual;
- ç) testimin psikologjik;
- d) testimi profesional (vetëm për personelin e orkestrës frymore dhe orkestrës simfonike të Forcave të Armatosura).

5.1. Komisionet dhe përbërja e tyre.

5.1.1. Komisionet e testimit përbëhen jo më pak se 3 (tre) anëtarë, ato ngrihen me urdhër të komandantit të QPR-së. Kur është e nevojshme, QPR-ja i kërkon SHPFA-së që ta mbështesë me personel dhe specialistë të disiplinave të ndryshme. Komisioni i Testimit Intelektual ka edhe atributet e Komisionit Qendror.

5.1.2. Komisioni i Testimit Profesional përcaktohet nga personel të Batalionit Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së (vetëm për testimin e kandidatëve të Orkestrës Frymore) ose Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura (vetëm për testimin e kandidatëve të Orkestrës Simfonike).

5.1.3. Komisioni Mjekësor Ambulator Ushtarak (KMAU) pranë NJMU-së është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

5.1.4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i cili përbëhet nga:

- a) një nënkolonel, përfaqësues i SHP (J-l), kryetar;
- b) një nënkolonel, përfaqësues i QPR-së, anëtar;
- c) një nënoficer me gradën "rreshter/kapter", përfaqësues i QPR-së, anëtar.

5.2. Testimi fizik.

5.2.1. Testimi fizik kryhet pas kontrollit të ekzaminimeve shëndetësore. Ai ka si qëllim të verifikojë standardet fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u rekrutuar si ushtarë/detarë në FA.

5.2.2. Kandidatët i nënshtrohen testimit fizik në disiplinat e mëposhtme:

- a) vrapim 1000 m;
- b) ulje-ngritje mbi krahë (pompa);
- c) palosje-shpalosje.

5.2.3. Testimi fizik zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Testimit Fizik, sipas normave të përcaktuara në **Aneksin A**, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5.2.4. Kandidati për ushtar/detar aktiv duhet të marrë minimumi **60 pikë në çdo disiplinë** testimi.

- 5.2.5.** Në rastet kur kandidatët pas testimit renditen poshtë këtij kufiri dhe numri i kandidatëve kundrejt kuotave të planifikuara nuk plotësohet, kriteri i sigurimit të minimumit 60 pikë në çdo disiplinë nuk aplikohet. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas listë-renditjes deri në plotësimin e numrit të kërkuar. Pikët e përfituara nga kandidati do të konsiderohen në përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tyre sipas forcave/specialiteteve.
- 5.2.6.** Në testin fizik kandidati duhet të paraqitet me veshje sportive të siguruara prej tij (bluzë e pantallona të shkurtra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete).
- 5.2.7.** Testimi fizik zhvillohet në prani të ambulancës dhe ekipit mjekësor. Ai zhvillohet në disa sesione dhe për disa ditë.
- 5.2.8.** Pas çdo sesiioni të testimit fizik, kandidatët listohen sipas pikëve. Listat e rezultateve, pasi firmosen nga anëtarët e komisionit, i dërgohet komandantit të QPR-së dhe hidhen brenda ditës në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Rezultatet u bëhen të ditura kandidatëve;
- 5.2.9.** Pas përfundimit të testimit fizik nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore gjenerohet "Raporti i rezultateve të testimit fizik". Raporti përmban: numrin, emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, gjatësinë, gjininë (mashkull ose femër), disiplinat e testimit, normat e arritura dhe sasinë e pikëve për çdo disiplinë, pikët totale të marra në testimin fizik.

5.3. Testimi intelektual.

- 5.3.1.** Nëpërmjet testimit intelektual synohet të vlerësohen niveli i njohurive dhe kulturës së përgjithshme, aftësitë për të gjykuar dhe vepruar, aftësitë e përqendrimit të vëmendjes, si dhe niveli i përgjithshëm i inteligjencës.
- 5.3.2.** Testimi intelektual kryhet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Testimit Intelektual.
- 5.3.3. Testi intelektual i përgjithshëm** përfshin verifikimin e njohurive në fushat e mëposhtme:
- a) arsyetim aritmetik;
 - b) njohja e kuptimit të fjalëve;
 - c) të kuptuarit e paragrafëve;
 - ç) njohuri matematikore;
 - d) njohuri të kulturës së përgjithshme.
- 5.3.4.** Fushat e testimit intelektual të përgjithshëm, përmbajtja e tyre, sasia e pyetjeve për çdo fushë, koha maksimale për zhvillimin e testimit për çdo fushë dhe kodi i tyre jepen në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Fusha e testimit	Koha	Sasia e pyetjeve	Kodi	Përmbajtja e fushave të testimit
1.	Arsyetimi aritmetik	36	30	AA	Vlerësohen njohuritë për zgjidhjen e problemeve bazë matematikore.
2.	Njohja dhe kuptimi i fjalëve	7	20	NKF	Vlerësohen aftësitë për të kuptuar përmbajtjen/kuptimin e fjalëve nëpërmjet sinonimeve.
3.	Kuptimi i paragrafëve	9	10	KP	Vlerësohet aftësia për të kuptuar ose nxjerrë informacione nga materiale ose paragrafë të shkruar.
4.	Njohuri matematike	24	25	NM	Vlerësohen njohuritë matematikore në fushën e koncepteve dhe aplikimit.
5.	Njohuri të kulturës së përgjithshme	8	20	NKP	Vlerësohen njohuritë në fushën e historisë, gjuhës shqipe, letërsisë, kushtetutës, ushtrisë, gjeografisë dhe aktualitetit.

5.3.5. Testi intelektual i përgjithshëm është test kualifikues për t'u bërë pjesë e FA-së (TKFA). Ai është ndërtuar me 105 pyetje, të cilat në total kanë 155 pikë. Çdo kandidat duhet të arrijë minimumi 70 pikë për t'u kualifikuar.

5.3.6. Në rastet kur kandidatët pas testimit renditen poshtë këtij kufiri dhe numri i kandidatëve kundrejt kuotave të planifikuara nuk plotësohet, kriteri i sigurimit të minimumit 70 pikë nuk aplikohet. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas listë-renditjes deri në plotësimin e numrit të kërkuar. Pikët e përfituara nga kandidati do të konsiderohen në përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tyre sipas forcave/specialiteteve.

5.3.7. Vlerësimi i çdo kandidati dhe kualifikimi i tij bëhet në mënyrë automatike nëpërmjet sistemit. Në përfundim të testimit, kompjuteri gjeneron për çdo kandidat sasinë e pikëve të grumbulluara.

5.3.8. Në përfundim të testimit intelektual të përgjithshëm nëpërmjet sistemit gjenerohet "Raporti i rezultateve të testimit intelektual të përgjithshëm", i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe i përcillet komandantit të QPR-së. Kandidatët listohen sipas pikëve, duke filluar nga ai që ka siguruar më shumë pikë.

5.3.9. Testimit intelektual zhvillohet për përcaktimin e specialiteteve. Ai zhvillohet menjëherë pas testit intelektual të përgjithshëm, për vlerësimin e njohurive në fushat e mëposhtme:

- shkencat e përgjithshme;
- mekanikën dhe automatizimin;
- elektronikën dhe informacionin;
- shërbimet mekanike.

5.3.10. Testimi intelektual për specialitete të zhvillohet vetëm në rastet kur kërkohet rekrutimi i kandidatëve sipas specialiteteve.

5.3.11. Fushat e testimit intelektual për specialitetet, përmbajtja e tyre, sasia e pyetjeve për çdo fushë, koha maksimale për zhvillimin e testimit për çdo fushë dhe kodi i tyre jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fushat e testimit	Koha	Pyetje	Kodi	Përmbajtja e fushave të testimit
1.	Shkencat e përgjithshme	11	25	ShP	Vlerësohen njohuritë në shkencat shoqërore, hapësinore, në fizikë dhe biologji.
2.	Informacion auto dhe shop oficinë	11	25	IAO	Vlerësohen njohuritë për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, për materialet, si druri dhe metalet.
3.	Informacion elektronik	9	20	EI	Vlerësohen njohuritë mbi elektricitetin, rrymën elektrike, qarqet, pajisjet dhe sistemet elektronike.
4.	Të kuptuarit e mekanikës dhe automatikës	19	25	KM	Vlerësohen njohuritë mbi mekanikën dhe pajisjet kryesore mekanike.

5.3.12. Rezultatet e testimit për specialitetet shërbejnë për të përcaktuar se cili specialitet është më i përshtatshëm për kandidatët.

5.3.13. Kandidati duhet të arrijë një minimum pikësh që të kualifikohet për specialitetin përkatës. Minimumi i pikëve që duhet të sigurojnë kandidatët është i ndryshëm për specialitete të ndryshme. Përbërja dhe minimumi i pikëve që kandidati duhet të sigurojë sipas specialiteteve jepet në **Aneksin B**, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5.3.14. Në përfundim të testimit sipas specialiteteve nëpërmjet sistemit gjenerohet “Raporti i rezultateve të kombinuara të testimit intelektual të përgjithshëm dhe testimit intelektual sipas specialiteteve”.

5.3.15. Një kopje e këtij raporti i dërgohet J-l në SHP, i cili e përdor atë për ndarjen e ushtarëve/detarëve sipas specialiteteve në përfundim të stërvitjes individuale bazë.

5.4. Testimi psikologjik.

5.4.1. Testimi psikologjik zhvillohet me qëllim që të verifikojë te kandidatët përgjegjshmërinë, motivimin, aftësinë e të menduarit dhe të gjykuarit, si dhe stabilitetin e sjelljes.

5.4.2. Testi psikologjik zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Testimit Psikologjik. Ai zhvillohet pas testimit intelektual.

5.4.3. Testi psikologjik zhvillohet në formë interviste dhe është skualifikues. Në çdo rast, arsyet e skualifikimit të kandidatëve motivohen me shkrim.

- 5.4.4.** Në përfundim të testimit psikologjik, komisioni përkatës i dërgon komandantit të QPR-së “Raportin e rezultateve të testimit psikologjik”. Raporti përmban: numrin, emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, rezultatet e testimit psikologjik dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit psikologjik “kalues” ose “mbetës”.

5.5. Ekzaminimet shëndetësore.

- 5.5.1.** Ekzaminimi shëndetësor i kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë kryhet nga personeli i Njësisë Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, sipas listës së dërguar nga komandanti i Qendrës së Personel-Rekrutimit.

- 5.5.2.** Komisioni Mjekësor i NJMU-së, përpara vlerësimit të gjendjes fiziko-shëndetësore dhe kryerjes të vizitës mjekësore të përgjithshme, duhet të disponojë për çdo kandidat, raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes, ekzaminimet klinik biokimike, serologjike dhe për agjentë infektiv, si dhe vizitat specialistike të cilat kryhen nga personeli mjekësor i NJMU-së dhe laboratorëve, si më poshtë:

- a) vlerësimi i gjendjes fiziko-shëndetësore të përgjithshme për çdo kandidat;
- b) ekzaminim radiografik të toraksit në dy projeksione, me qëllim përjashtimin e sëmundjeve të mosnjohura, ekzistenca e të cilave mund të jetë me pasoja për individin dhe komunitetin e Forcave të Armatosura;
- c) vizitat: pneumolog; kardiologu (të shoqëruara me EKG kur nga mjeku kardiolog ka dyshime për ndonjë patologji të mundshme); okulist; otorinolaringolog; psikiatër; neurolog; psikolog; alergolog; endokrinolog; infeksionist; gastrohepatolog; vizitë për aparatin osteo-muskular superior dhe inferior, vizitë kirurgu;
